

VENDIM
Nr.360, datë 10.8.1992

**PËR SHPEJTIMIN E PROGRESEVE TË RIORGANIZIMIT TË SHKOLLAVE TË
LARTA DHE TË KËRKIMEVE SHKENCORE**

Pasi shqyrtoi gjendjen në shkollat e larta e në institucionet kërkimore-shkencore, punën e bërë për reformimin e tyre në kushtet e reja politiko-shoqërore, si dhe përballimin e detyrave që koha u ngarkon, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe Komiteti i Shkencës e i Teknologjisë t'i propozojnë kryetarit të Këshillit të Ministrave për miratim përbërjen e një grupi të posaçëm pune, i cili të hartojë rregulloren e re të kualifikimit shkencor pasuniversitar për marrjen e gradave e të titujve shkencorë, në përputhje me përvojën tonë e praktikën përparimtare botërore, dhe ta paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave brenda datës 30 tetor 1992.

2. Ministria e Arsimit dhe Komiteti i Shkencës e i Teknologjisë t'i propozojnë për miratim kryetarit të Këshillit të Ministrave përbërjen e një komisioni të posaçëm, i cili do të përcaktojë temat shkencore ose të veprimtarisë mësimdhënëse të fushave të ndryshme, mbi bazën e të cilave janë dhënë grada e tituj shkencorë, e që kanë qenë të lidhura a të frymëzuara drejtpërdrejt nga doktrina marksiste-leniniste, vija e ish-PPSH-së ose në shërbim të saj. Këto grada e tituj shkencorë të pezullohen për një periudhë njëvjeçare nga data që mbajtësi i tyre do të njoftohet prej këtij komisioni. Brenda këtij afati për personat e mësipërm të vazhdojë trajtimi ekonomik e financiar i mëparshëm, por ndërkohë ata duhet të atestohen sipas rregullave që do të përcaktohen në rregulloren e re për kualifikimin shkencor pasuniversitar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi